

**V E N D I M**  
**Nr. 325, datë 27.6.2002**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË**  
**USHTARAKËVE”, ME NDRYSHIMET PÛRKATËSE NË VENDIMIN NR.54, DATË**  
**27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SISTEMIN E PAGAVE TË MINISTRISË**  
**SË RENDIT PUBLIK DHE USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË” DHE NË**  
**VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN**  
**ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE NË SHËRBIMIN INFORMATIV**  
**SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.60, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 10 500 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë bëhet 40 100 lekë në muaj.

b) Në pikën 2, paga e ushtarakëve, nxënësve dhe studentëve ushtarakë bëhet 1 165 lekë në muaj.

c) Në pikën 5, paragrafi i tretë, paga për ushtarin rezervist bëhet deri në 816 lekë në ditë.

ç) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura 100 000 lekë

- Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të

Armatosura dhe Komandant i Forcave Tokësore 81 650 lekë

- Komandant i Forcave Detare dhe Komandant i Forcave Ajrore 75 800 lekë

- Komandant i Doktrinave dhe Komandant i Komanës Logjistike 71 100 lekë

- Këshilltar i ministrit dhe drejtor drejtorie 64 700 lekë.

2. Në vendimin nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bazë të ushtarakut të sistemit të Ministrisë së Rendit Publik bëhet 9 400 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 39 200 lekë në muaj.

Niveli më i ulët i pagës bazë të ushtarakut të sistemit të Ministrisë së Drejtësisë bëhet 9 400 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë 35 600 lekë në muaj.

b) Në pikën 3, paga e ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm, kursantëve dhe studentëve të shkollave të Ministrisë së Rendit Publik bëhet deri në 1 085 lekë në muaj.

c) Paga e ushtarakëve të sistemit të Ministrisë së Rendit Publik, pagë e cila është përcaktuar me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave (jashtë sistemit të pagave me klasa), rritet në masën 8 për qind.

ç) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë 100 000 lekë

- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë 78 000 lekë

- Komandant i Gardës së Republikës 78 000 lekë

- Drejtor i Policisë së Burgjeve 61 400 lekë

3. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 9 400 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 36 000 lekë në muaj.

b) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Inspektor i Përgjithshëm në Shërbimin

Informativ Shtetëror 99 000 lekë

Drejtor i Departamentit Informativ 87 000 lekë

Drejtor drejtorie në aparatin qendror

Shef i kabinetit

Drejtor i Drejtorisë së Tiranës 64 700 lekë

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI

**Pandeli Majko**